



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

63
KKDM/Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27/06/2022

VENDIM

Nr.17, datë 27/06/2022

PËR

RAPORTIN VJETOR NE LIDHJE ME GJENDJEN, MONITORIMIN, MIREMBAJTJEN DHE

SIGURINE E DIGAVE TE UJITJES QE ADMINISTROHEN NGA MBZHR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 27.06.2022 mori në shqyrtim Raportin vjetor për gjendjen, monitorimin, mirembajtjen dhe sigurinë e digave të ujitjes që administrohen nga MBZHR. Në mbledhje ishin prezent edhe përfaqësues të MBZHR. Gjatë mbledhjes u diskutua në lidhje me disa problematika të konstatuara gjatë shqyrtimit të këtij raporti si me poshte:

- Megjithatë në disa diga janë instaluar instrumenta të monitorimit të tyre përmes një projekti të financuar nga BB, asnjë e dhënë e matur nuk jepet në raportin vjetor
- Mirembajtja e digave të ujitjes është mjaft e dobët dhe në disa raste si në digën e Murriz Thanë është inekzistente duke rritur rrezikun e demtimeve në dige
- Në kundërshtim me nenin 28 të VKM nr. 147 të mesiperme, mungojnë Planet e emergjencave civile në rast të prishjes së mundshme të ndonjë dige apo prurjeve maksimale të mundshme.
- Në kundërshtim me 30 të VKM nr.147 të mesiperme dhe kërkesave të KKDM, mungojnë matjet e depozitimeve të ngurta në rezervuarët e krijuar nga këto diga duke sjelle edhe mungesë informacioni në lidhje me jetegjatesinë e tyre si dhe problematika në lidhje me menaxhimin dhe shfrytezimin e tyre
- Mungojnë Vlerësimet e aseteve të digave dhe elementeve kryesore të tyre (sistemeve të shkarkimit dhe ujeleshuesve)

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

VENDOSI:

- 1- **Ti kërkoj MBZHR përgatitjen e një Raporti dhe informacioni të detajuar** në lidhje me problematikën e mësipërme dhe masat e parashikuara për zgjidhjen e tyre në të ardhmen. Ky informacion duhet të përfshihet në Raportin 6 muajor të kërkuar sipas nenit 28 të VKM Nr.147 dhe legjislacionit në fuqi. Në Raport duhet të jepen:
 - a. Informacion në lidhje me matjet e kryera me instrumenta të monitorimit të digave të Murriz Thanë, Belesovë dhe Kurjan. Ky informacion duhet të shoqërohet edhe me rezultatet e këtyre matjeve dhe konkluzionet përkatëse të bazuar në këto matje.
 - b. Informacion për zgjidhjen e problematikës së matjeve të volumeve aktuale të ujit në rezervuarët e krijuar nga digat e Murriz Thanë, Kurjan, Belesovë, Shtodër, Gjanc dhe Dofti Bulo
 - c. Informacion në lidhje me zgjidhjen e problematikës së hartimit të planeve të emergjencave civile dhe miratimit të tyre nga KKDM dhe AKMC.
 - d. Informacion në lidhje me Vlerësimin e aseteve të 8 digave nën administrim të MBZHR duke përfshirë edhe metodologjinë e këtij vlerësimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- 2- **Ti kërkoj MBZHR informacion në lidhje me programin e investimeve për rehabilitimin e 130 digave dhe marrjen e masave për dekomisionimin e 70 digave të percaktuara nga MBZHR në strategjinë kombetare të kullimit dhe të Ujitjes. Ky informacion duhet të shoqërohet edhe me listën e digave që janë parashikuar të rehabilitohen dhe digave që janë parashikuar të dekomisohen si dhe me një informacion në lidhje me stadin e përgatitjes së termave të referencës për projektin përkatës të financuar nga Banka Botërore.**
- 3- **Raporti dhe informacioni i mësipërm duhet të dorëzohet pranë KKDM brenda muajit Korrik 2022.**
- 4- **Në baze të nenit 37 të VKM Nr. 147 të mësipërm, Ti kërkoj MBZHR ngritjen e një grupi pune dhe përgatitjen e programit të punës për kontrollin shtetëror të digave që administrohen nga MBZHR. Perfaqësues të KKDM do të jenë pjesë përbërëse e grupit të punës. Raporti teknik me rezultatet e këtij kontrolli dhe konkluzionet përkatëse në lidhje me gjëndjen e digave, monitorimin dhe mirëmbajtjen e tyre si dhe me sigurinë e digave dhe të zonave urbane poshtë tyre duhet të dorëzohet pranë KKDM brenda muajit Nëntor 2022.**

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

